



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Departmentant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr. 51/2021

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, znj. Diellza Hoxha dhe z. Rushit Hoxha, anëtarë të Komisionit Disiplinor, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesve privat

dhe si organ përmbarues të emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në , pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Burbuqe Spahija - Kërveshi, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, dhe përmbaruesve privat dhe dhe pas seancës këshillimore dhe votimit, me datën 08.12.2021, mori si në vijim:

V E N D I M

KONSTATOHEN të tërhequra Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-51/2021, e paraqitur me datën 01.11.2021, si dhe Ankesa e palës ankuese, e paraqitur përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, me datën 28.10.2021, përkatësisht me datën 29.10.2021.

A R S Y E T I M

Me datën 28.10.2021, përkatësisht, me datën 29.10.2021, pala ankuese, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar ka paraqitur Ankesë ndaj përmbaruesve privat në vijim: si organ përmbarues të emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në Sipas palës ankuese, përmbaruesit privat të lartpërmendur kanë refuzuar, pa ofruar ndonjë arsytim me shkrim, të ndërmarrin veprime përmbarimore lidhur me lëndën C. Nr 3527/19 të datës 10.03.2021, me pretendimin se kjo lëndë nuk është në kompetencë të përmbaruesve privat. Rrjedhimisht, pala

ankuese paraqet që, përmbartesit privat duke mos pranuar ndërmarrjen e veprimeve përmbartimore pa ndonjë arsye, kanë bërë shkelje të dispozitave ligjore.

Me datën 01.11.2021, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, ka paraqitur Raportin Përfundimtar në Komisionin Disiplinor ndaj përmbartesve privat në vijim:
dhe si organ përmbartes të emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në

Përmbartesit privat dhe
, kanë paraqitur përgjigjen e tyre duke kundërshtuar pretendimet e ngritura për shkelje disiplinore.

Me datën 19.11.2021, Komisioni Disiplinor ka pranuar Njoftimin se pala ankuese tërhiqet nga Ankesa.

Me datën 08.12.2021, Komisioni Disiplinor ka mbajtur seancën dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, znj. Burbuqe Spahija - Kërveshi, dhe përmbartesit privat dhe Përmbartesit privat, dhe si dhe pala ankuese, dhe përfaqësuesi i tij, edhe pse ishin të njoftuar në mënyrë të rregullt, nuk kanë prezantuar në seancën dëgjimore.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, znj. Burbuqe Spahija - Kërveshi ka theksuar se pasi që paraqitësi i propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ka njoftuar Komisionin Disiplinor që është tërhequr nga ankesa e paraqitur ndaj përmbartesve privat, atëherë, edhe Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat tërhiqet nga Raporti përfundimtar DPL. Nr 51/21, dt 01.11.2021, i paraqitur në Komision Disiplinor.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 51/2021, datë 08.12.2021

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.